



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

C.nr.20/2018

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëseve S.K.dhe A. K.nga fshati B./Malishevë dhe Z. Th. nga fshati B./Malishevë të cilat sipas autorizimit i përfaqëson Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, kundër të paditurës Kompania e Sigurimit “Kosova e Re” me adresë lagja “Kalabria”, blloku B1-Prishtinë, me objekt kontesti Dëmshpërblim-kompensim dëmi, jashtë seancës me datë 15.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore me shenjën C.nr.20/2018, për shkak të hapjes së procedurës së falimentimit (procedurës së likuidimit të detyrueshëm) ndaj të paditurës “Kosova e Re” me seli në Prishtinë.
- II. Procedura e ndërprerë në këtë çështje do të vazhdoj kur përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e merr përsipër procedurën, apo kur t’a thërrasë gjykata ta bëjë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditëset S. K. dhe A. K. nga fshati B./Malishevë dhe Z. Th. nga fshati B./Malishevë, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, me datë 30.01.2018 kanë parashtruar padi në këtë gjykatë ndaj të paditurës Kompania e Sigurimit “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi-dëmshpërblim” në aksident trafiku.

Gjykata zyrtarisht është informuar se siguruesit “Kosova e Re” i është revokuar licenca Nr.007 e datës 25 prill 2002 nga Autoriteti Bankar dhe i pagesave të Kosovës, paraardhës ligjor i Bankës Qendrore të Kosovës.

Gjithashtu janë hapur procedurat e likuidimit të detyrueshëm sipas ligjit për sigurimet nr.05/L-045 dhe bazuar në vendimin nr.70-24/2021 të datës 24.09.2021, z.N. L. emërohet Likuidator i Siguruesit “Kosova e Re” Sh.a-Kosovë.

Me rastin e vënies në dijeni të këtij fakti, gjykata iu referua dispozitës së nenit 277 pika d) të LPK-së, e cila përcakton se: “*Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues*”, ndërsa me nenin 280, paragrafi 1 të po këtij ligji, është paraparë se procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277, pika a) - d) të këtij ligji, do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Gjykata vë në dukje se në kuptim të dispozitës nga neni 279 të LPK-së, si rezultat i ndërprerjes së kësaj procedure, rrjedhimisht ndërpritën edhe afatet për zhvillimin e veprimeve

procedurale dhe gjatë kësaj kohe gjykata nuk mund kryej kurrfarë veprimesh procedurale, e po ashtu veprimet e kryera nga ndonjëra prej palëve ndërgjyqëse nuk prodhojnë kurrfarë efekti juridik ndaj palës kundërshtare, deri në momentin e vazhimit eventual të procedurës.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se e paditura është në procedurën e likuidimit të detyrueshëm, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.20/2018, datë 15.03.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.